



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.94	2005	14 dhjetor
--------------	-------------	-------------------

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Akt normativ nr.4, datë 13.12.2005	Për një shtesë në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, të ndryshuar.....	3019
Vendim i KM nr.761, datë 6.12.2005	Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare, jopublike “Universiteti “Kristal””.....	3019
Vendim i KM nr.763, datë 6.12.2005	Për një ndryshim në rregulloren për zbatimin e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, miratuar me vendimin nr.153, datë 7.4.2000 të Këshillit të Ministrave.....	3020
Vendim i GJK nr.32, datë 2.12.2005	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.341, datë 12.02.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si antikushtetues.....	3020
Vendim i KRTSH nr.377, datë 30.11.2005	Për dhënie licence për televizionin vendor privat “TV 6”.....	3023
Vendim i KKRT nr.378, datë 30.11.2005	Për dhënie licence për radion vendore private “Egnatia”.....	3023
Vendim i KKRT nr.379, datë 30.11.2005	Për dhënie licence për televizionin vendor privat “Vlora Channel”.....	3024
Vendim i KKRT nr. 380, datë 30.11.2005	Për dhënie licence për radion vendore private “Radio 6”.....	3024
Vendim i KKRT nr.381, datë 30.11.2005	Për dhënie licence për televizionin vendor privat “TV Scutari”	3025
Vendim i KKRT nr.385, datë 30.11.2005	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv vendor “TV Klaudiana”.....	3025

Vendim i KKRT nr.386, datë 30.11.2005	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv vendor “TV Teuta”.....	3026
Vendim i KKRT nr.387, datë 30.11.2005	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv vendor “TV Mati”.....	3026
Vendim i KKRT nr.388, datë 30.11.2005	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv vendor “TV Puka”.....	3027
Vendim i KKRT nr.389, datë 30.11.2005	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv vendor “Tirana TV”.....	3027
Vendim i KKRT nr.390, datë 30.11.2005	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik “Prespa”.....	3028
Vendim i KKRT nr.391, datë 30.11.2005	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik “Alsat”.....	3028
Vendim i KKRT nr.392, datë 30.11.2005	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv vendor “TV Kuçova”.....	3029
Vendim i KKRT nr.393, datë 30.11.2005	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv vendor “TV Egnatia”.....	3029
Vendim i KKRT nr.394, datë 30.11.2005	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv vendor “TV Shkodra”.....	3030
Vendim i KKRT nr.395, datë 30.11.2005	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv vendor “TV Onufri”.....	3030
Vendim i KKRT nr.396, datë 30.11.2005	Për dhënie licence për televizionin vendor privat “TV Era”.....	3031

AKT NORMATIV
Nr.4, datë 13.12.2005

PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.8405, DATË 17.9.1998, “PËR URBANISTIKËN”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në fund të nenit 21 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, të ndryshuar, të shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“KRRT-ja e qarkut ose e bashkisë mblidhet jashtë radhe, edhe në rastet kur këtë e kërkon KRRTRSH-ja, me vendim me rend dite të përcaktuar. Kur kryetari i KRRT-së së qarkut ose bashkisë refuzon zbatimin e vendimit të KRRTRSH-së, atëherë mbledhja e KRRT-së thirret nga prefekti. Prefekti cakton me urdhër anëtarin e KRRT-së që do ta drejtojë mbledhjen. Mbledhja, në kërë rast, zhvillohet në selinë e prefektit. Mbledhja është e vlefshme kur marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve të KRRT-së.”.

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.761, datë 6.12.2005

PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE,
JOPUBLIKE “UNIVERSITETI “KRISTAL””

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1, 12 e 13 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare, jopublike “Universiteti “Kristal””.

2. Shkolla e lartë universitare, jopublike “Universiteti “Kristal””, me seli qendrore në Tiranë (Mëzez, komuna Kashar), do të ketë tri fakultete:

- Fakultetin e Administrimit të Biznesit;
- Fakultetin e Drejtësisë;
- Fakultetin e Farmacisë dhe të Stomatologjisë.

3. Shkolla e lartë universitare, jopublike “Universiteti “Kristal”” do të japë:

a) Në Fakultetin e Administrimit të Biznesit, diplomë universitare në këto degë:

- Financë (3 vite akademike);
- Menaxhim biznesi (3 vite akademike).

b) Në Fakultetin e Drejtësisë, diplomë universitare në këtë degë:

- Juridik (3 vite akademike).

c) Në Fakultetin e Farmacisë dhe të Stomatologjisë, diplomë universitare në këto degë:

- Farmaci (3 vite akademike);
- Stomatologji (5 vite akademike).

4. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Shkencës të kryejë procesin e vlerësimit dhe të akreditimit të kurseve të studimit dhe zbatimin e ligjshmërisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.763, datë 6.12.2005

PËR NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN PËR ZBATIMIN E KODIT RRUGOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, MIRATUAR ME VENDIMIN NR.153, DATË 7.4.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 3 e nenit 224 të rregullores për zbatimin e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, miratuar me vendimin nr.153, datë 7.4.2000 të Këshillit të Ministrave, riformulohet si më poshtë vijon:

“3. Ndalohet vendosja e perdeve, errësimi i xhamave të autoveturave, si dhe përdorimi i xhamave të errëta, të fabrikuar, të pahomologuara nga prodhuesi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.32, datë 2.12.2005

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 14.07.2005, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.36 Akti, që i përket:

KËRKUESI: KUJTIM GJILANI (SPAHIU), përfaqësuar nga avokat Agim Hoxha, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. BASHKIA Durrës, në mungesë.

2. TRASHËGIMTARËT E ZANA DHE SELAMI SPAHIUT, përfaqësuar nga avokat Ilia Kona, me deklaram.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr.341, datë 12.02.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si antikushtetues.

Kërkuesi ka kërkuar shfuqizimin e vendimit të lartpërmendur, duke pretenduar për zhvillim të një procesi të parregullt ligjor në këto aspekte:

- Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vepruar në kundërshtim me ligjin, pasi për të njëjtat rrethana e fakte është shprehur krejt ndryshe nga sa pranohet në vendimin e Kolegjeve të Bashkuara. Në këtë mënyrë, Kolegji ka vepruar në kundërshtim me përmbajtjen e nenit 486 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit: “Udhëzimet dhe konkluzionet e Gjykatës së Lartë, janë të detyrueshme për gjykatën që rishqyrton çështjen” dhe të nenit 493/2 të këtij Kodi, sipas të cilit: “Detyrat e lëna nga Gjykata e Lartë janë të detyrueshme për gjykatën që rishqyrton çështjen”.

- Kolegji Civil, në kundërshtim me detyrat e tij funksionale e ligjore, i ka vlerësuar provat krejt ndryshe nga sa i kishte vlerësuar gjykata e apelit. Në këtë mënyrë, Kolegji ka mbajtur një qëndrim që bie ndesh dhe me praktikën unifikuese të Gjykatës së Lartë.

- Gjykata e Lartë e ka kaluar çështjen për gjykim duke vepruar në kundërshtim me përmbajtjen e nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Fehmi Abdiu, përfaqësuesit e kërkuarit, të subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Gjykata e Rrethit Durrës, me vendimin nr.339, datë 17.02.1997, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së paraqitur nga kërkuari. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Kasacionit.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.6, datë 18.01.2002, kanë vendosur prishjen e vendimeve nr.2770, datë 19.11.1997 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe nr.747, datë 06.05.1998 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit, dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Durrës.

Gjykata e Apelit Durrës, në rishqyrtim, me vendimin nr.503, datë 17.10.2002, ka pranuar kërkesën e kërkuarit.

Mbi ankimin e subjektit të interesuar, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka prishur vendimin nr.503, datë 17.10.2002 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe ka lënë në fuqi vendimin nr.339, datë 17.02.1997 të Gjykatës së Rrethit Durrës.

Sipas kërkuarit, Kolegji ka mbajtur qëndrim të kundërt me atë të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë si përsa i përket problemeve ligjore për zgjidhjen e konfliktit, ashtu dhe mënyrës së vlerësimit të provave të paraqitura nga palët gjatë rigjykimit të çështjes.

Gjykata Kushtetuese në lidhje me këtë pretendim e çmon të nevojshme të analizojë një aspekt të veçantë të kontrollit kushtetues që ajo ushtron ndaj vendimeve të gjykatave me juridiksion të zakonshëm. Kontrolli kushtetues ndaj vendimeve të gjykatave është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes të së drejtës kushtetuese të çdo individ për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e tyre.

Rreth konceptit të procesit të rregullt ligjor, Gjykata Kushtetuese ka krijuar tashmë një praktikë të konsoliduar, sipas së cilës problemet e zbatimit të ligjit e të interpretimit të tij, sa kohë që nuk shoqërohen me cenimin e të drejtave themelore kushtetuese, nuk përbëjnë juridiksion kushtetues. Pra, si rregull, mënyra e të kuptuarit dhe e të zbatuarit të ligjit është atribut i gjykatës me juridiksion të zakonshëm. Duke qenë kështu, pretendimi i kërkuarit, përsa kohë ka të bëjë me mënyrën e zbatimit të ligjit konkret, nuk mund të pranohet.

Nuk mund të merret parasysh për pranimin e kërkesës as pretendimi tjetër, sipas të cilit vendimi i Kolegjit Civil është antikushtetues se ka bërë një vlerësim të ndryshëm të provave nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe nga gjykata e apelit që e ka rigjykuar çështjen.

Duke prishur vendimin e Gjykatës së Apelit Durrës e duke lënë në fuqi atë të Gjykatës së Rrethit Durrës, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, sipas vlerësimit të saj, ka vepruar konform nenit 485 shkronja “b” të Kodit të Procedurës Civile, prandaj Gjykata Kushtetuese çmon se ajo nuk duhet të vihet në pozitë të një gjykate superiore të sistemit të drejtësisë. Në fakt, Gjykata Kushtetuese nuk vlerëson aspektin e ligjshmërisë kur ajo nuk është e lidhur konkretisht me kushtetutshmërinë e procesit gjyqësor.

Veç kësaj, sipas nenit 141 të Kushtetutës, Gjykata e Lartë ka funksion fillestar dhe rishikues. Për njësimin e praktikës gjyqësore ose për ndryshimin e saj, ajo ka të drejtë të tërheqë për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore.

Në veprimtarinë e gjykatave ndeshen edhe qëndrime të ndryshme rreth kuptimit të ligjit, të cilat duhen evituar, prandaj për të arritur këtë, Gjykata e Lartë ndjek nga afër veprimtarinë e tyre në rrugën e zakonshme të shqyrtimit të rekurseve; e sa herë që ajo konstaton qëndrime të ndryshme ligjore për të njëjtin problem, në zbatim të kësaj detyre, ndërhyr nëpërmjet vendimeve unifikuese. Vendimi unifikues nuk ka aq rëndësi për zgjidhjen e çështjes konkrete se sa për t’i dhënë ligjit kuptimin uniform të tij.

Në këtë këndvështrim, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se pranimi ose jo i pretendimeve të kërkuarit duhet parë i lidhur ngushtë edhe me kompetencat e asaj gjykate.

Gjykata Kushtetuese e çmon të nevojshme ta trajtojë këtë problem në lidhje edhe me një parimin tjetër kushtetues: të pavarësisë së gjyqtarit në vendimmarrje. Sipas këtij parimi, edhe në rishqyrtim, gjykata e mbështet vendimin e saj në ligj, në kritere objektive e në prova, të cilat merren mbi bazën e vlerësimit të vetë gjyqtarëve, që janë të pavarur në përmbushjen e detyrës së tyre funksionale.

Në rast se ndodhemi para një vendimi gjyqësor të mbështetur mbi shkelje, ai mund të riparohet nëpërmjet apelitit e rishikimit nga instancat gjyqësore që kanë të drejtë të riparojnë shkeljet e ndodhura. Kjo zgjidhje, e cila i shërben parimit të sigurisë juridike, ka si element të tij edhe moskrijimin e kushteve të tilla që mund të bëjnë të vështirë përfundimin e procesit gjyqësor ose, siç quhet ndryshe, një sistem drejtësie pa fund.¹

Edhe pretendimi tjetër se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka shqyrtuar në seancë gjyqësore një rekurs që, sipas kërkuarit, është në kundërshtim me praktikën unifikuese të Gjykatës së Lartë, nuk qëndron. E drejta për të vlerësuar nëse rekursi përmban ose jo shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile, i përket Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i cili, në dhomë të këshillimit, vendos për pranimin ose jo të rekursit, sipas nenit 480 të Kodit të Procedurës Civile. Ky proces seleksionimi që zhvillon Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë është një çështje që ligji e ka lënë në vlerësim të tij dhe për rrjedhojë Gjykata Kushtetuese nuk mund ta bëjë objekt të shqyrtimit të saj nëse vlerësimi i bërë nga Kolegji është ose jo në përputhje me ligjin procedural, pra nëse çështja është kaluar me ose pa të drejtë në seancë gjyqësore, përse kohë nuk konstaton se nga ky qëndrim preket një e drejtë kushtetuese.

Për të gjitha këto arsye, Gjykata Kushtetuese çmon se procesi gjyqësor i zhvilluar nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk përmban elementë antikushtetutshmërie, prandaj kërkesa e kërkuarit duhet rrëzuar si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë në neneve 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

¹ Vendime të Gjykatës Kushtetuese Gjermane, B Verf GE.49,148 “164”, 87, 48, “65”

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM
Nr.377, datë 30.11.2005

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVISIONIN VENDOR PRIVAT
“TV 6”
SUBJEKTIT: AQIF HAVERIKU

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të miratuar me vendimin nr.176, datë 18.9.2003 të KKRT-së, si dhe të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht për periudhën korrik-gusht, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit z.Aqif Haveriku licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike, për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal qytetin e Kavajës.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.378, datë 30.11.2005

PËR DHËNIE LICENCE
PËR RADIO VENDORE PRIVATE “EGNATIA”
SUBJEKTIT: “EGNATIA-RADIO TV KABËLL” SH.P.K.

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të miratuar me vendimin nr.176, datë 18.9.2003 të KKRT-së, si dhe të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht për periudhën korrik-gusht, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit “Egnatia-Radio Tv Kabëll” sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator vendor radio FM private, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore, me modulim në frekuencë për një periudhë prej 3 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal qytetin e Elbasanit.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.379, datë 30.11.2005

PËR DHËNIE LICENCE

PËR TELEVISIONIN VENDOR PRIVAT
“VLORA CHANNEL”

SUBJEKTIT: “VLORA CHANNEL” sh.p.k.

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të miratuar me vendimin nr.176, datë 18.9.2003 të KKRT-së, si dhe të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht për periudhën korrik-gusht, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit “Vlora Channel” sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike, për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal qytetin e Vlorës.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr. 380, datë 30.11.2005

PËR DHËNIE LICENCE
PËR RADION VENDORE PRIVATE
“RADIO 6”

SUBJEKTIT: AQIF HAVERIKU

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të miratuar me vendimin nr.176, datë 18.9.2003 të KKRT-së, si dhe të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht për periudhën korrik-gusht, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit z.Aqif Haveriku licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator vendor radio FM private, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore, me modulim në frekuencë për një periudhë prej 3 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal qytetin e Kavajës.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.381, datë 30.11.2005

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVISIONIN VENDOR PRIVAT
“TV SCUTARI”
SUBJEKTIT: GJERGJ LIQEJZA

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të miratuar me vendimin nr.176, datë 18.9.2003 të KKRT-së, si dhe të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht për periudhën korrik-gusht, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit z.Gjergj Liqejza licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike, për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal rrethin e Shkodrës.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.385, datë 30.11.2005

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV VENDOR
“TV KLAUDIANA”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas licencës nr.001/TVL, të rinovojë për një afat të ri 5-vjeçar në fushën e transmetimeve televizive tokësore analogjike, subjektin fizik Gazmend Vogli, për televizionin “TV Klaudiana”.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 8.11.2005 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.386, datë 30.11.2005

**PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV VENDOR
“TV TEUTA”**

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas licencës nr.009/TVL, të rinovojë për një afat të ri 5-vjeçar në fushën e transmetimeve televizive tokësore analogjike, subjektin “TV Teuta” sh.p.k. për televizionin “TV Teuta”.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 8.11.2005 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Halil Lalaj**

**VENDIM
Nr.387, datë 30.11.2005**

**PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV VENDOR
“TV MATI”**

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas licencës nr.019/TVL, të rinovojë për një afat të ri 5-vjeçar në fushën e transmetimeve televizive tokësore analogjike, subjektin “Vani” sh.p.k. për televizionin “TV Mati”.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 8.11.2005 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Halil Lalaj**

**VENDIM
Nr.388, datë 30.11.2005**

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV VENDOR “TV PUKA”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas licencës nr.003/TVL, të rinovojë për një afat të ri 5-

vjeçar në fushën e transmetimeve televizive tokësore analogjike, subjektin “TV Puka” sh.p.k. për televizionin “TV Puka”.

2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 8.11.2005 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.389, datë 30.11.2005

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT VENDOR “TIRANA TV”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë si dhe kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas licencës nr.021/TVL, të rinovojë për një afat tëri 5-vjeçar në fushën e transmetimeve televizive tokësore analogjike, subjektin “Tirana TV” sh.a. për televizionin “Tirana TV”.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 8.11.2005 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.390, datë 30.11.2005

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK “PRESPA”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas licencës nr.037/FML, të rinovojë për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë, subjektin fizik z.Llazi Nikolla për “Radio Prespa”.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 10.9.2005 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.391, datë 30.11.2005

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK “ALSAT”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit,

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas licencës nr.038/FML, të rinovojë për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë, subjektin për “Radio Alsat 1” sh.p.k. për “Radio Alsat”.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 7.10.2005 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.392, datë 30.11.2005

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK “TV KUÇOVA”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas licencës nr.013/TVL, të rinovojë për një afat të ri 5-vjeçar në fushën e transmetimeve televizive tokësore analogjike, subjektin fizik Adnan Shehu, për televizionin “TV Kuçova”.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 8.11.2005 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.393, datë 30.11.2005

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK “TV EGNATIA”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas licencës nr.011/TVL, të rinovojë për një afat të ri 5-vjeçar në fushën e transmetimeve televizive tokësore analogjike, subjektin “Egnatia Televizion” sh.a. për televizionin “TV Egnatia”.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 8.11.2005 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.394, datë 30.11.2005

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV VENDOR “TV SHKODRA”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas licencës nr.015/TVL, të rinovojë për një afat të ri 5-vjeçar në fushën e transmetimeve televizive tokësore analogjike, subjektin “Media Nord” sh.a. për televizionin “TV Shkodra”.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 8.11.2005 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.395, datë 30.11.2005

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV VENDOR “TV ONUFRI”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas licencës nr.014/TVL, të rinovojë për një afat të ri 5-vjeçar në fushën e transmetimeve televizive tokësore analogjike, subjektin “Onufri TV” sh.a. për televizionin “TV Onufri”.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 8.11.2005 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.396, datë 30.11.2005

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVIZIONIN VENDOR PRIVAT “TV ERA”
SUBJEKTIT: ARBEN CAKA

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit z.Arben Caka licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike, për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal qytetin e Ersekës.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

Fletorja Zyrtare gjendet: duke u abonuar pranë njësive postare të qyteteve ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare; në adresën: Bulevardi Zhan d'Ark, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot" Tel: 042 555 63; 267 468
Për më tepër informacion vizitoni faqen e internetit:
www.legjislacionishqiptar.gov.al ose www.qpz.gov.al

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

REGJISTRAT E NOTERISË SIPAS FORMATIT TË MIRATUAR NGA MINISTRIA E DREJTËSISË 2005

1. REGJISTRI I PËRGJITHSHËM I AKTEVE DHE I VEPRIMEVE NOTERIALE	1500
2. REGJISTRI I TESTAMENTEVE	1200
3. REGJISTRI I DEPOZITIMIT TË PARAVE OSE VLERAVE TË TJERA	1000
4. INDEKSI ALFABETIK	1000

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK.....	1500
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (Botim, 2005)	600
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë).....	1500
4. PËR TAKSAT DHE TATIMET.....	1500
1. TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-Korrik 2004 ...	1500
2. TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-Korrik 2004.....	2000

BOTIME TË REJA

1. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim i II-të)	1500
2. KODI DOGANOR	1000
3. KODI DETAR	1000

Doli nga shtypi më 14.12.2005

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2005

Çmimi 100 lekë